



**KUSHTET E SIGURIMIT TE VETE MJETIT MOTORIK NGA  
PERPLASJA ME NJE MJET TJETER MOTORIK**

**“ MINI KASKO ”**

Adresa :

Bulevardi “Zogu I”, Nr.1, Tirane, Kutia Postare 2387 , Tel 04 253 407/ 04 253 408;

Tel/Fax 04 250 220 / 04 233 308 E-mail : [info@uniqa.al](mailto:info@uniqa.al)

**KONTRATË SIGURIMI “MINI KASKO”**  
**KUSHTET E PËRGJITHSHME**

**1. OBJEKTI I KONTRATËS SE SIGURIMIT (RREZIKU I SIGURUAR).**

Sigurimi i vetë mjetit motorrik në lëvizje dhe nen drejtimin e te siguruarit/perdoruesit i përcaktuar si i tillë në kontratën e sigurimit/policen e sigurimit, nga dëmtimet materiale që pëson nga përplasja e tij ne rruge me një mjet tjetër motorrik po ashtu ne levizje, i identifikuar, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, ngjarje kjo e vërtetuar me (i) raportin e policisë, (ii) foto te mjeteve te perfshira ne vendngjarje si dhe me (iii) skicen perkatese te vendit te ngjarjes.

## **Baza ligjore**

Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, Ligji nr.52 /2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit” Kushtet e kësaj Kontrate Sigurimi

## **2. PËRKUFIZIME :**

“**Siguruesi**” sipas kësaj kontrate nënkupton shoqërinë e sigurimeve SIGAL UNIQA Group AUSTRIA sh.a

”**Pronar i mjetit të siguruar**” sipas kësaj kontrate nënkupton personin fizik natyror ose tregtar, juridik të specifikuar si të tillë në certifikaten e pronësisë dhe/ose lejen e qarkullimit dhe i shnuar në policën e sigurimit;

“**I siguruari**” sipas kësaj kontrate sigurimi nënkupton vetëm personin fizik natyror të specifikuar si i siguruar në policën e sigurimit, dhe që në rast shkaktimi dëmi mjetit motorrik, i jep të drejtën pronarit të mjetit të përfitoje dëmshpërblim për dëmet e pësuar në mjetin motorrik.

“**Mjeti motorrik i siguruar**” sipas kësaj kontrate sigurimi nënkupton mjetin e percaktuar si të tillë në policën e sigurimit, për të cilin është percaktuar rreziku, periodha e sigurimit dhe është paguar primi i sigurimit.

“**Dëmtim aksidental**” sipas kësaj kontrate sigurimi nënkupton një ngjarje të papritur, të paparashikuar, e cila shkaktohet drejtpërdrejtë në mjetin motorrik të siguruar dhe në lëvizje, vetëm si rezultat i përplasjes me një mjet tjetër motorrik po ashtu në lëvizje.

“**Mjet motorrik**” sipas kësaj kontrate sigurimi nënkupton të gjitha mjetet motorrike sipas përcaktimeve të bëra në ligjin “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.

“**Përfitues**” sipas kësaj kontrate sigurimi nënkupton pronarin e mjetit të siguruar sipas perkufizimit me lart në këtë police personin fizik ose juridik që përfiton nga kontrata e sigurimit sipas dispozitave ligjore në fuqi.

“**Rrugë**” sipas kësaj kontrate nënkupton zonën për përdorim publik e destinuar për qarkullimin e mjeteve motorrike të inventarizuara në regjistra publike.

## **3. RREZIQET E SIGURUARA:**

**3.1** Siguruesi do të dëmshpërblejë të siguruarin deri në limitin maksimal të përgjegjësisë (shuma e sigurimit) percaktuar në Policën e Sigurimit, për dëmet materiale të shkaktuara mjetit motorrik në lëvizje, i cili rezulton i siguruar nga:

- a. dëmtimi aksidental i mjetit motorrik në lëvizje, vetëm me një mjet tjetër motorrik në lëvizje, të identifikuar drejtpërdrejtë nga i siguruari/perdoruesi i percaktuar si i tillë kontratën e sigurimit/policën e sigurimit. Rasti i sigurimit duhet të vërtetohet detyrimisht me raportin e policisë, foto të mjeteve të përfshira në vendngjarje, të vendit të ngjarjes si dhe skicën e vendit të ngjarjes.

**3.2** Kjo kontratë sigurimi është e vlefshme vetëm për një rast sigurimi (vetëm për një rast dëmi) të ndodhur gjatë periudhës së vlefshmerisë së sigurimit.

## **4. PËRJASHTIME NGA MBULIMI NË SIGURIM I MJETIT TË SIGURUAR**

4.1 Në rast dëmtimi aksidental të mjetit, Siguruesi nuk do të dëmshperblejë të siguruarin për:

- a. Dëmet shëndetësore;
- b. Veprime të qëllimshme të të siguruarit apo të përdoruesve të mjetit motorik sipas kontratës së sigurimit;
- c. Shkak të veprimeve të kryera me dashje ose të tentuara nga i Siguruari, dhe/ose e gjendjes së të Siguruarit nën efektin e alkoolit, drogës apo narkotikëve të ndryshëm ose kur i siguruari refuzon t'i nënshtrohet provave të këtij kontrolli;
- d. Humbjet ose dëmtimet e mjetit motorik të siguar gjatë qëndrimit dhe riparimit të tij në servis;
- e. Shkak apo si rrjedhojë e luftës së cdo lloji, invazionit, luftimeve të tjera të armatosura pavarësisht në se është deklaruar lufta ose jo, luftës civile, shpalljen e ligjit të luftës, deklarimin e gjendjes së jashtëzakonshme, turbullirave civile, revolucionit, lëvizjeve separatiste, kryengritjes popullore, rebelimeve, revoltave, pucit, grushtit të shtetit, eksodit, sabotimit, konfiskimeve, rekuizimeve, shtetëzimeve të detyruara të kryera me urdhër të çdo lloj qeverie apo autoriteti shtetëror, trazirave, grevave, lokautit, terrorizmit. Për qellime të kësaj police me termin terrorizëm, do të kuptohet përdorimi i dhunës për qëllime politike, përfshirë çdo përdorim dhune që ka si qëllim ngjalljen e frikës mbi popullsinë;
- f. Dëmet e shkaktuar gjatë përdorimit të mjetit nga përdorues emrat e të cilëve nuk figurojnë në policën e sigurimit **si të siguar**.
- g. Shkak të qarkullimit të mjetit në rrugë të painventarizuara apo pa lejuara për të qarkulluar;
- h. Shkak apo si pasojë e bllokimit ose në proces bllokimi nga Organet e Shtetit;
- i. Dëme, ose humbje të objekteve, sendeve personale, mallrave ose bagazheve, që ndodhen në mjetin e siguar në momentin e rastit të sigurimit.
- j. Shkak të ose si pasoje e neglizhencës të të Siguruarit, ose mosmarrjes së masave parandaluese.
- k. Shkak të përdorimit të një mjeti në ngjarje sportive të autorizuara ose jo në rrugë apo pjesë rrugësh, të palejuara për drejtim të mjetit, për arritjen e shpejtësive mesatarisht të larta apo për t'u stërvitur për gara;
- l. Fitimin e munguar;
- m. Dëmet e shkaktuara nga, **drejtuesi kur nuk ka leje të vlefshme të drejtimit të mjetit motorik, sipas kategorisë apo tipit të mjetit, ose drejtuesit të mjetit motorik i është konfiskuar/pezulluar/hequr leja e drejtimit, apo i është ndaluar përdorimi i lejes së drejtimit, të lëshuar nga një shtet tjetër për në territorin e Republikës së Shqipërisë;**
- n. Dëmet e shkaktuara mjetit të siguar, të parkuar dhe/ose ndaluar, kur goditet nga një mjet tjetër në lëvizje;
- o. Dëmet e shkaktuara mjetit motorik të siguar, kur vetë mjeti i siguar godet një objekt të palevizshëm, qoftë ky edhe një mjet motorik i parkuar apo ndaluar në anë të rrugës.
- p. Aksident që dyshohet dhe/ose provohet që i siguruari ka marrë përsipër fajesinë për aksidentin.
- q. **Dëmet e shkaktuara nga mjeti që nuk ka certifikatë të kontrollit teknik të vlefshme në momentin e aksidentit.**
- r. **Dëmet e shkaktuara nga mjeti kur drejtuesi i mjetit largohet nga vëndngjarja.**

## **5. SHTRIRJA TERRITORIALE E MBULIMIT NE SIGURIMIN**

Mbulimi në sigurim, është i vlefshëm vetëm për dëmtime aksidentale të ndodhura gjatë lëvizjes të mjetit motorrik të siguar me një mjet tjetër motorrik gjithashtu në lëvizje të ndodhura brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

## **6. SHUMA E SIGURUAR DHE PRIMI I SIGURIMIT**

**6.1** Rreziku i siguar sipas Policës së Sigurimit, mbulohet në sigurim për shumën e sigurimit të përcaktuar në policën e sigurimit, në rast jo më shumë se sa vlera e tregut të mjetit. Siguruesi ka të drejtë të ndryshojë shumën e sigurimit në rast se shumën e sigurimit është me e lartë se vlera e mjetit në treg duke njoftuar dhe të siguruarin.

**6.2** I Siguruarit detyrohet t'i paguajë Siguruesit primin e sigurimit sipas shumës dhe afatit të përcaktuar në kontratë (policën e sigurimit). Primi i sigurimit paguhet në një pagesë të vetme dhe është i detyrueshëm për tu paguar me lëshimin e policës së sigurimit.

**6.3** Pagesa e primit të sigurimit paguhet pranë Degës ose agjencisë së Siguruesit ku është lëshuar Polica e Sigurimit. Pagesa do të quhet e kryer në momentin e kalimit të shumës së caktuar në llogarinë Bankare të Siguruesit.

**6.4** Kur pas lidhjes së kontratës së sigurimit pushon interesi pasuror i të siguarit, në dobinë e të cilit është lidhur kontrata, Kontrata e sigurimit automatikisht deklarohet e zgjidhur.

## **PJESA E ZBRITSHME**

**6.5.** Në rast dëmi dhe/ose demshperblimi, siguruesi do të zbrisë nga shumën e demshperblimit, pjesën e zbritshme masa e të cilës është e përcaktuar në Policën e Sigurimit.

## **7. POLICA E SIGURIMIT**

**7.1** Siguruesi i dorëzon të Siguarit një dokument të firmosur nga të dyja palët – “Policën e Sigurimit”-që vërteton njohjen dhe pranimin e Kushteve të Përgjithshme dhe të Veçanta nga i Siguruarit si dhe lidhjen e Kontratës së Sigurimit.

**7.2** Në se Polica e Sigurimit humbet ose dëmtohet në masën që bëhet e paperdorshme, me kërkesën dhe shpenzimet e të Siguarit, Siguruesi duhet të lëshojë një dublikatë të saj.

**7.3** Kjo policë Sigurimi ka efekt vetëm për një ngjarje sigurimi të ndodhur gjatë periudhës së mbulimit në sigurim dhe për rrezikun e mbuluar sipas policës së sigurimit.

**7.4** Siguruesi ka të drejtë të verifikojë vërtetësinë e njoftimeve dhe deklarimeve të të Siguarit dhe të kryejë inspektime për saktësime të dhënash.

## **8. PERIUDHA E SIGURIMIT**

**8.1** Kjo kontratë, vlen për demin që ndodhë gjatë periudhës së treguar në policën e sigurimit. Periudha e sigurimit është një vjeçare.

**8.2** Mbulimi në sigurim, fillon në orën 24.00 të ditës të nesërme të përcaktuar si dite e fillimit të periudhës së fillimit të mbulimit dhe përfundon në orën 24.00 të ditës të përcaktuar si ditë mbarimi në Policën e Sigurimit, me kusht që të jetë paguar më parë primi

i sigurimit. Nëse nuk është paguar primi i sigurimit kontrata e sigurimit nuk hyn në fuqi dhe nuk krijon efekte juridike për palët.

**8.3** Në rastet kur pagesa e primit të sigurimit është kryer më parë, Përgjegjësia e Siguruesit, fillon në momentin kohor të përcaktuar në policë, pavarësisht momentit të kryerjes së pagesës të primit. Pra, përgjegjësia e Siguruesit do të fillojë në momentin kohor të përcaktuar në policë, edhe nëse pagesa e primit të sigurimit kryhet më parë.

## **9. ZGJIDHJA DHE PERFUNDIMI I POLICES SE SIGURIMIT**

**9.1** Kontrata e sigurimit, është e pavlefshme, nëse vërtetohet se, rreziku i sigurimit nuk ka ekzistuar ose ka pushuar së qeni para lidhjes së kontratës.

**9.2** Kontrata e sigurimit përfundon:

- a.) Në qoftë se rreziku i sigurimit pushon së ekzistuari pas nenshkrimit të kontratës sigurimit, por siguruesi ka të drejtën e pagimit të primit deri në momentin që pushimi i rrezikut të sigurimit t'i jetë njoftuar ose t'i jetë bërë e ditur në një mënyrë tjetër.
- b.) Me shqyrtimin e kërkesës për dëmshpërblim, të paraqitur nga i Siguruari, kur ky shqyrtim, sipas kushteve të policës apo legjislacionit në fuqi, rezulton me shpërblimin e demit nga siguruesi.
- c.) Me pushimin e interesit pasuror të siguruarit mbi mjetin (përfshirë ndryshimin e pronësisë)

## **10. DETYRIME TË TË SIGURUARIT**

**10.1** I Siguruari, duhet të informojë me shkrim Siguruesin, për të gjitha rrethanat e njohura prej tij dhe që janë thelbësore për përcaktimin e natyres dhe masës së rrezikut. Rrethanat, konsiderohen thelbësore nëse ato janë të një natyre të tillë, që mund të influencojnë në vendimin e Siguruesit, për të lidhur ose refuzuar kontratën, apo për kushtet e saj. Siguruesi, ka të drejtë të zgjidhë Policën e Sigurimit brenda 45 ditëve nga fillimi i saj, për shkak të pasaktësisë së informacionit të dhënë nga i Siguruari apo në rastin kur informacioni është i gabuar. Në këtë rast, i Siguruari, nuk ka të drejtë të kërkojë kthimin e primit të sigurimit.

**10.2** I Siguruari, pas lidhjes së Kontratës së Sigurimit, duhet të njoftojë me shkrim cdo ndryshim në objektet e siguruar, që sjellin si pasojë ndryshimin, shtimin ose pakesimin e rrezikut.

Siguruesi, ka të drejtë, nga çasti i shtimit të rrezikut, të ndryshojë masën e primit të sigurimit, të shumës së sigurimit, afatin e sigurimit, ose të zgjidhë kontratën. Mosnjoftimi nga i Siguruari sipas pikes 10.2 me lart, sjell si pasojë çlirimin e Siguruesit nga detyrimi për pagesën e dëmshpërblimit.

**10.3** I Siguruari, duhet të ndërmarrë hapa të arsyeshëm, për të parandaluar apo pakesuar dëmtimet apo humbjet në mjetin motorik, si dhe të sigurohet të mbaje mjetin në gjendje pune dhe funksionale sipas përcakimeve ligjore perkatëse.

**10.4** Nëse i Siguruari kryen një tjetër sigurim ( dysigurim) për mbulimin e rreziqeve në përputhje me këto Kushte të Përgjithshme, ai duhet t'i njoftojë Siguruesit të parë emrin e siguruesit tjetër si dhe shumën e siguruar. Në rast se, qëllimisht apo për shkak të neglizhencës i Siguruari nuk plotëson detyrimet sipas paragrafit të mësipërm, Siguruesi ka të drejtë të zgjidhë policën e sigurimit dhe të mos kthejë primin.

**10.5** Në rastin e dysigurimit, masa e dëmshpërblimit nga të dy kontratat, nuk mund të jetë më e madhe se vlera e humbjes duke zbritur pjesën e zbritshme. Nëse i siguruari kryen

sigurime të tjera me qëllim që të arrijë përfitime të paligjshme, kontrata e sigurimit quhet e pavlefshme dhe Siguruesi mban primin e sigurimit.

**10.6** Në rast dëmi, Siguruesi lirohet nga detyrimi për dhënie dëmshpërblimi kur shkak i dëmit është një rrethanë që nuk i ishte bërë e njohur Siguruesit nga i Siguruari kur ky i fundit kishte apo duhej të kishte dijeni për rrethanën në fjalë dhe rrethana është e një rëndësie të tillë që ndikon në dhënien ose jo të dëmshpërblimit.

**10.7. Siguruesi dhe i Siguruari**, mund të bien dakord për sigurimin e mjetit motorrik për një **shumë sigurimi** më të vogël se vlera e tregut apo e blerjes së mjetit motorrik.

Në këtë rast, dëmshpërblimi që do të përfitojë **i Siguruari**, do të llogaritet duke shumëzuar, vlerën e dëmit me koeficientin e nënsigurimit. Koeficienti i nënsigurimit, është raporti i shumës së siguruar kundrejt vlerës së tregut apo të blerjes së mjetit motorrik.

**10.8.** Nënsigurimi, do të zbatohet, edhe nëse në momentin menjëherë para ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, shuma e siguruar, është më e ulët se vlera e tregut apo e blerjes së mjetit motorrik.

**10.9** Nëse, Shuma e Siguar, është përcaktuar më e lartë se vlera e tregut apo vlera e blerjes së të njëjtit mjet motorrik, **Siguruesi dhe i Siguruari** veçmas ose bashkarisht, bëjnë ndryshimet përkatëse në Policën e Sigurimit, duke zvogëluar si Shumën e Siguar ashtu dhe Primin e Sigurimit.

**10.10** Në çdo rast, kufiri i përgjegjësisë së **Siguruesit**, nuk do të jetë më i lartë se vlera e tregut apo vlera e blerjes së të njëjtit tip mjet motorrik, duke zbritur pjesën e zbritshme. Në këtë rast, dëmshpërblimi që do të përfitojë **i Siguruari**, do të llogaritet duke shumëzuar, vlerën e dëmit me koeficientin e mbisigurimit. Koeficienti i mbisigurimit, është raporti i shumës së siguruar kundrejt vlerës së tregut apo të blerjes së mjetit motorrik.

**10.11.** Nëse, **i Siguruari**, lidh kontratën e sigurimit me qëllim që të arrijë përfitime nga mbisigurimi, kontrata konsiderohet e pavlefshme. **Siguruesi**, ka të drejtën e mbajtjes së primit të sigurimit.

## **11. SHPERBLIMI I TE SIGURUARVE QË KANE PËSUAR NJË DËM TË SHKAKTUAR NGA NJË PERSON I CILI KA QENË NË DREJTIMIN E NJË MJETI TJETËR MOTORIK TË SIGURUAR DHE OSE TE PASIGURUAR.**

Përveç sa është parashikuar në pjesën e përgjithshme të kësaj kontrate sigurimi për dëmet materiale të shkaktuar të siguruarit nga persona të tretë parashikohet se :

11.1 I Siguruari në rast të shpërblimit të dëmit të shkaktuar nga një drejtues i një mjeti tjetër motorrik, sipas kësaj kontrate sigurimi, automatikisht nëpërmjet kësaj kontrate sigurimi në referencë dhe të dispozitave të Kodit Civil, i kalon të gjitha të drejtat e tij për kërkimin e dëmshpërblimit shoqërisë së sigurimeve SIGAL UNIQA Group AUSTRIA, kundrejt personit përgjegjes shkaktar të dëmit dhe/ose shoqërisë siguroese të tij.

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA, zë vendin e Përfituesit/ të Siguarit kundrejt personit shkaktar dhe ka të drejtë të kërkojë kthimin e shumës, ose të cdo të drejte tjetër ligjore, ndaj personit shkaktar të dëmit dhe /ose shoqërisë siguroese të tij.

I Siguruari, vepron, me të gjitha mënyrat e duhura për të siguruar këto të drejta dhe nuk do të bëjë asnjë veprim për të paragjykuar këto të drejta.

Siguruesi shpërblen te siguruarin sipas vleres se demit, por jo me shume se limiti i përgjegjesise (shuma e sigurimit), duke i riparuar mjetin ne nje nga serviset e autorizuar nga siguruesi ose siguruesi mund te vendose dhe demshperblimin ne vleren e demit pas

heqjes se pjeses se zbritshme te shenuar ne police dhe pa kaluar shumen e siguruar te shenuar ne police.

11.2 Pasi Siguruesi ka paguar të Siguararin e tij në lidhje me dëmin pasuror/material të shkaktuar nga një palë e tretë gjate drejtimit te nje mjeti tjetër motorrik, ze vendin e te siguruarit ne te drejta kundrejt shkaktarit dhe ka të drejtë t'i drejtohet palës së tretë shkaktare e dëmit dhe/ose shoqërisë siguruese të tij, për të rimbursuar/kompensuar/shperblyer dëmin në vlerën e plotë të tij përfshirë interesa dhe shpenzime të tjera. Pasi Siguruesi ezauron të gjitha rrugët e bashkëpunimit me mirëkuptim dhe jashtegjyqesore konform procedurave dhe afateve të përcaktuara në legjislacionin për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit, legjitimohet në të drejtën e tij t'i drejtohet Gjykatës për zgjidhjen e konfliktit dhe rimbursimin e shumave përkatëse.

## **12. NJOFTIMI I RASTIT TË SIGURIMIT DHE DËMSPËRBLIMI NGA PËRPLASJA E VETË MJETIT MOTORRIK, TË PËRGJITHSHME**

12.1 I Siguarari duhet të njoftojë siguruesin për rastin e sigurimit brenda një periudhe prej 24 orësh nga momenti i ndodhjes së tij. Në se i Siguarari nuk bën njoftimin si më sipër, Siguruesi ka të drejtë të mos paguajë dëmshpërblimin.

12.2 I Siguarari duhet të plotësojë formularin “Vërtetimi Miqësor i Ngjarjes-Njoftimi i Rastit të Sigurimit”, si dhe detyrimisht ta vërtetojë rastin e sigurimit me anë të raportit të policisë dhe t’ia paraqesë atë Siguruesit, të shoqëruar me të gjitha të dhënat identifikuese përkatëse të mjetit motorrik të dëmtuar, si edhe rrethanat përkatëse të ndodhjes së Rastit të Sigurimit. Formulari standart i njoftimit të rastit të sigurimit, duhet të plotësohet me besnikëri dhe në afatet e mësipërme, pa shtrembërime të fakteve të rastit të sigurimit nga i Siguarari. Në rast të kundërt, Siguruesi, ka të drejtën, të refuzojë pagesën e dëmit.

12.3 Është kusht thelbesor për përgjegjësinë e Siguruesit, që për cdo ngjarje që mund të jetë shkak për kërkesë për dëmshpërblim, i Siguarari, menjëherë duhet:

a.) Të njoftojë Siguruesin, duke specifikuar rrethanat e ngjarjes. Një njoftim i tillë, do të konsiderohet i dhënë Siguruesit, nëse është dhënë brenda 24 orëve nga ndodhja e ngjarjes.

b.) Në rastin e ndodhjes së aksidentit, i Siguarari, detyrohet menjëherë të njoftojë sipas rastit të sigurimit, Policinë Rrugore, të Rendit ne momentin e ndodhjes apo konstatimit të tij dhe të vërë në dispozicion të Siguruesit, vërtetimin e autoriteteve të lartpërmendura, lidhur me njoftimin e bërë.

c.) T’i paraqesë siguruesit raportin e organeve të policisë rrugore mbi aksidentin e ndodhur, skicen e vendit ngjarjes dhe foto te vendit ngjarjes;

ç.) Të shmangë dhe minimizojë humbjet ose dëmtimet aq sa është e mundur.

12.4 I Siguarari, për dëmet në mjetin e siguruar, paraqet kërkesë për dëmshpërblim brenda afateve të parashikuar nga Kodi Civil, vetëm pasi ka bërë njoftimin e rastit të sigurimit nëpërmjet formularit standart.

12.5 Siguruesi, gëzon të drejtën të çlirohet nga detyrimet e tij për dëmshpërblim nëse:

a.) I Siguarari, me qëllim apo për neglizhencë, nuk zbaton tërësisht apo pjesërisht detyrimet e tij;

- b.) I Siguruari, përpiqet të paraqesë në mënyrë të shtrembër ose mashtruese, faktet para Siguruesit, fakte të cila kanë rëndësi për pergjegjesine e siguresit dhe/ ose masën e dëmshpërblimit.

**12.6** Siguruesi ka të drejtë të verifikojë rrethanat në të cilat ka ndodhur Rasti i Sigurimit si edhe të kryejë ekspertizën e dëmit ose të humbjeve në mjetin motorrik të siguruar ose të dëmit shëndetsor, brenda 10 ditësh nga dita e njoftimit të Rastit të Sigurimit. Gjatë kësaj periudhe, i Siguruari është i detyruar të mbajë mjetin motorrik të dëmtuar në dispozicion të Siguruesit, pa e riparuar atë.

**12.7** Siguruesi, për dëmtimet materiale përcakton formë dëmshpërblimi:

- a. Vlerën e dëmit të perlogaritur pasi i është zbritur pjesa e zbritshme e percaktuar në policen e sigurimit ose nëse nuk pranon
- b. Riparim i mjetit të dëmtuar, në servis të ofruar nga Siguruesi. Në këtë rast i siguruari paguan pjesën e zbritshme

**12.8** Trajtimi i kërkesës për dëmshpërblim mund të pezullohet nga Siguruesi:

- a. Për atë kohë sa ekzistojnë dyshime mbi të drejtën e të Siguruarit, për të marrë pagesën.
- b. Në qoftë se, janë filluar hetime penale, në lidhje me ngjarjen e sigurimit kundër të Siguruarit.
- c. Për atë kohë sa, i Siguruari, nuk paraqet dhe plotëson dokumentat e kërkuara nga Siguruesi.

**12.9** Kur vlera e dëmit material është më e lartë se 80% e shumës së siguruar, mjete motorrike do të konsiderohet dëm total. Në rastin e dëmit material total, dëmshpërblimi do të jetë i barabartë me shumën e siguruar minus pjesën e mbetur, duke i zbritur pjesën e zbritshme sipas përcaktimit në policën e sigurimit.

**12.10** Në rastin e dëmit material të pjesshëm, dëmshpërblimi do të jetë i barabartë me shpenzimet e riparimit minus pjesën e zbritshme sipas përcaktimit në policën e sigurimit.

**12.11** Siguruesi nuk do të dëmshpërblejë dëme vlera të cilave është më e vogël se pjesa e zbritshme fikse.

**12.12** Në rast pagese dëmshpërblimi, sipas kësaj kontrate, **Siguruesit SIGAL UNIQA Group AUSTRIA sh.a** nepermjet kësaj kontrate në bazë dhe të nenit 1142 të Kodit Civil i kalon të drejtën për të kërkuar kthimin e shumës të paguar ndaj çdo personi ose subjekti që është përgjegjës për shkaktimin e dëmit përfshirë dhe shoqëritë e sigurimit të shkaktarit.

**I Siguruari**, do të veprojë, me të gjitha mënyrat e duhura për të siguruar këto të drejta dhe nuk do të bëjë asnjë veprim për të paragjykuar këto të drejta.

### **13. MBROJTJA E TË DHENAVE PERSONALE**

I siguruari është njohur me deklaratën e privatesisë të shoqërisë së sigurimeve dhe autorizon SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a që të mbledhë dhe përpunojë të dhënat dhe informacionin personal i cili nevojitet për administrimin e kontratës së sigurimit, për dhënie të shërbimeve ndaj të siguruarit dhe përfituesit përfshirë trajtimin e dëmit, për ofrimin e produkteve apo shërbimeve të reja, bazuar në ligjet përkatëse në fuqi (Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”) si dhe transferimin e të dhënave personale tek të tretë për qëllime të sigurimit apo biznesi të cilët garantojnë



gjithashtu mbrojtjen e të dhënave personale. Ne cdo rast, mbrojtja e të dhënave personale do të behet ne përputhje me rregullat dhe procedurat e percaktuara ne Ligjin Nr. 9887, date 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

#### **14. E DREJTA E INFORMIMIT**

14.1 I siguruari ka te drejten te informohet nga Siguruesi mbi kushtet, procedurat dhe afatet e mbulimit dhe/ose perfitimit nga sigurimi, informim i cili fillon para nënshkrimit të kontratës dhe vazhdon gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës. Informimi merret nepermjet telefonit, e-mailit, faqes zyrtare ne internet apo broshurave informative te perdoruara nga shoqeria.

14.2 I siguruari eshte informuar nga Siguruesi përpara nënshkrimit të kontratës së sigurimit, duke marre te gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me te dhenat juridike te siguruesit, llojin përkatës të sigurimit, procedurat, afatet, metodat e trajtimit te kerkesave per demshperblim, rreziqet e mbuluara dhe te perjashtuara, metodat e llogaritjes, afatet dhe menyra e pageses se primit, metoden e llogaritjes se vleres se kompesueshme dhe cdo informacion tjetër qe ka lidhje me kontraten e sigurimit.

#### **15. E DREJTA E TE SIGURUARIT PER TU ANKUAR**

I siguruari apo persona të tjerë të interesuar, kane te drejte të paraqesin një ankesë pranë shoqërisë së sigurimit, ne rast se cmojne se shoqeria e sigurimit nuk u përmbahet kushteve të vendosura në kontratën e sigurimit. Ankesa mund te paraqitet ne forme elektronike (e-mail) ose me shkrim ne adresen postare te shoqerise. Shoqëria e sigurimit do ti pergjigjet çdo ankesë të depozituar me shkrim apo në formë elektronike dhe do te jap çdo informacion të kërkuar që ka lidhje me kontratën e sigurimit, brenda afateve te percaktuara ne ligj.

Kjo kontratë sigurimi hartohet dhe zbatohet në përputhje me kushtet e percaktuara si më sipër, Kodin Civil, Ligjin nr.52 te vitit 2014 “Për veprimtarinë e sigurimeve dhe risigurimeve”

**16.** Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve zgjidhet me mirëkuptin, në të kundërt, kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjes është Gjykata e Rrethit Gjyqësor të vendit, ku ka qendrën i padituri apo ku është shkaktuar dëmi. Palet në rast konflikti angazhohen ta zgjidhin çështjen nëpërmjet institutit të ndërmjetësimit.

**17.** Korrespondenca midis Siguruesit dhe të Siguruarit do të zhvillohet me letër ose letër rekomande.

Për gjithcka jo të parashikuar në këto kushte, do të zbatohen dispozitat përkatëse të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe legjislacioni tjetër në fuqi.

**PAGESA E PRIMIT TE SIGURIMIT DHE LESHIMI I POLICES TE SIGURIMIT VERTETOJNE SE PALET KANE RENE DAKORT ME INFORMACIONIN E DHENE PARAPRAKISHT, KANE LEXUAR DHE KUPTUAR TE GJITHA TERMAT DHE KUSHTET E KESAJ KONTRATE SIGURIMI, DHE PRANOJNE ME VULLNET TE LIRE T’I RESPEKTOJNE DHE ZBATOJNE ATO.**

**MIRATOHET**

**Avni PONARI**  
**Administrator i Përgjithshëm**